



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
- Këshilli Drejtues -

V E N D I M

Nr.2516, datë 06.11.2014

Për

**“Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 12, datë 07.04.2010
“Për te dhenat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve
dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 06.11.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shteterore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 12, datë 07.04.2010
“Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve
dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”**

B A Z A L I G J O R E:

1. Gërma p) e nenit 8, nenet 31-39, neni 110, 114 dhe 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji nr.9918**);
2. Rregulloren nr. 12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” (**Rregullore Nr.12**).

3. Vendimi nr. 2404, datë 26.12.2013 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentit për Këshillim Publik: “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
(Vendimi nr. 2404)
4. Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik”, miratuar me Vendim nr.1183, datë 10.03.2010, të Këshillit Drejtues të AKEP,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si dhe diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke i’u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Dokumentacioni i paraqitur nga Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut, Tarifave dhe Shërbimit Postar dhe Grupi i Punës, përbëhet nga:
 - a. Projekt Vendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;;
 - b. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
 - c. Dokumenti: “*Komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP mbi komentet*”;
 - d. Komentet e palëve të interesuara për ndryshimet e propozuara nga AKEP
 - e. Dokumenti me Shtesat dhe Ndryshimet në Rregullore nr. 12, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
 - f. Formularet me treguesit e rishikuar që operatorët e komunikimeve elektronike duhet të depozitojnë në AKEP
2. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 2404, datë 26.12.2013, vendosi të miratojë për Këshillim Publik projekt aktin administrativ “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 12, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
3. Propozimet e AKEP për amendimin e Rregullores së vitit 2010, ishin:
 - a) Menyren e dërgimit të të dhënave statistikore dhe financiare (duke përdorur modulën on-line në faqen zyrtare të AKEP, me qëllim lehtësimin e komunikimit ndërmjet AKEP dhe ofruesve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve në tregun e komunikimeve elektronike;
 - b) Heqjen e Formularëve përkates, në versionin e “ngurtësuar” të tyre, duke i konsideruar si të mundshëm për ndërhyrje në përmbajtjen e tyre, në varesi të

zhvillimeve të teknologjive dhe kërkesave për të dhëna shtese, duke eliminuar kështu nevojën për amendime të mëvonshme të rregullores;

c) Duke shtuar një nen të vecantë për cilësinë dhe ruajtjen e të dhënave të raportuara në AKEP nga sipërmarrësi.

4. Konsultimi publik u krye në periudhën 06.01.2014 – 05.02.2014. Në përfundim të periudhës së konsultimit u dërguan komente nga palët e interesuara:

- Albtelecom sh.a (shkresë Prot nr.307, dt 07.02.2014),
- Vodafone Albania sh.a (shkresë Prot nr.188, dt 30.01.2014) si dhe komente shtese të VF, me shkresë Prot.381,date 17.02.2014, dhe
- Plus Communication sh.a (shkresë Prot nr.184, dt 30.01.2014).

5. Nga komentet e palëve të interesuara vihet re se palët ishin dakort me ndryshimet në rregullore për amendimet e propozuara, por vihet re se:

- nga disa palë ka një paqartësi në lidhje me heqjen formularëve si pjesë e rregullores.
- nga një palë kërkohet që me heqjen e formularëve si pjesë e rregullores, AKEP duhet të konsultohet paraprakisht për hartimin dhe ndryshimet e tyre në kohë.
- kërkohet që gjurma e ngarkimit nga sipërmarrësit i formularëve të plotësuar në modulën on-line të ruhet e qartë dhe e identifikueshme (në kohë /ditë/orë dhe përmbajtje) që të garantohet saktësi dhe transparencë të plotë për të dy palët në process.

6. Në lidhje me paqartësinë e parë, AKEP sqaron se heqja e formularëve nga rregullorja, nuk nënkuptonte se nuk do të ketë formularë me tregues për tu plotësuar nga operatorët, por që do të ketë formularë me tregues që mund të ndryshojnë në kohë, dhe këta tregues dhe cdo ndryshim i tyre do të hartohen nga AKEP, duke i ngarkuar në modul dhe duke i njoftuar paraprakisht operatorët në kohën e përshtashme për plotësim të tyre. Pra heqja bëhet me qëllim që cdo ndryshim në formularë të mos ketë nevojë për ndryshim në rregullore.

Në lidhje me komentin e dytë, AKEP sqaron se komenti është i drejtë dhe AKEP u konsultua paraprakisht me operatorët kryesore për rishikim të treguesve dhe përkufizimet përkatëse. AKEP me datë 29.08.2014 dërgoi draftin e treguesve të rishikuar me gjithë përkufizimet dhe më datë 26.09.2014 zhvilloi takim me operatorët kryesorë për diskutimin e propozimit të AKEP. Versioni final i treguesve të rishikuar ka marrë në konsideratë edhe komentet e operatorëve gjatë takimit të cituar.

Në lidhje me komentin e tretë AKEP sqaron se dërgimi i të dhënave me modul ka filluar të aplikohet që në Janar 2013 krahas dërgimit me shkresë dhe CD-ROM. Në këtë periudhë AKEP nuk ka ndeshur probleme me operatorët në lidhje me gjurmën e raportimit, e cila aktualisht jepet nga sistemi në formën e ‘konfirmimit’ të të dhënave nga stafi përktaës i AKEP. Në bazë të manualit të përdorimit të modulit on-line të AKEP, secili sipërmarrës pajiset me ‘user name’ dhe ‘passëord’ dhe komunikimet ruhen nga moduli dhe serverat e AKEP. Mënyra e dërgimit të të dhënave me modul on-line, si mënyra e vetme e dërgimit të të dhënave aplikohet tashmë që prej fillimit të

vitit 2013 edhe me operatorët postarë, dhe AKEP nuk ka hasur probleme në lidhje me gjurmën e raportimit.

7. AKEP, në zbatim të nenit 110 të ligjit nr. 9918, dt. 19.05.2008 i ndryshuar, pas përfundimit të afatit për këshillim publik, duke marrë në konsideratë komentet e palëve te interesuara, ka përgatitur dokumentin “Komentet e palëve te interesuara dhe qëndrimi i AKEP mbi komentet” si dhe ndryshimet dhe plotësimet finale në rregulloren Rregulloren nr. 12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.
8. AKEP është këshilluar me operatorët kryesorë për rishikimin e treguesve të formularëve dhe përkufizimeve të tyre. Formularët e rishikuar përmbajnë ndryshime nga formularët e mëparshëm:
 - a. për treguesit e përfshirë;
 - b. përfshirje të përkufizimeve të treguesve bazuar ne dokumentat dhe udhëzimet e ITU¹ dhe Komisionit Evropian;
 - c. afatet e raportimit të të dhënave nga operatorët, duke kaluar nga gjashtëmujore dhe vjetore në tremujore dhe vjetore.

Ndryshimet në formularë gjykohen të arsyeshme për shkak të zhvillimeve të tregut, kërkesave të institucioneve ndërkombëtare dhe objektivit të përmirësimit të cilësisë së të dhënave të raportuara nga operatorët dhe publikuara nga AKEP.

9. AKEP në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe në përputhje me Udhëzuesin e Procedurave për Këshillimin me Publikun miratuar me Vendim nr. 1183, datë 10.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP, çmon si të arsyeshme miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti, si për AKEP ashtu dhe për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, bazuar në germën p) të nenit 8, nenet 31-39, neni 110, 114 dhe neni 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S:

1. Të miratojë shtesat dhe ndryshimet në Rregulloren nr. 12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, sipas dokumentit bashkëlidhur ne Aneks 1.

¹ Handbook for the collection of administrative data on Telecommunications/ICT 2011

2. Të miratojë qëndrimin e AKEP mbi komentet e palëve të interesuara sipas dokumentit bashkëlidhur: “*Komentet e palëve te interesuara dhe qëndrimi i AKEP mbi komentet*”, sipas dokummentit bashkëlidhur në Aneks 2.
3. Ky Vendim dhe dokumentet e miratuara të publikohen në faqen e internetit të AKEP www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**

Aneks 1: Shtesat dhe Ndryshimet ne Rregulloren nr. 12, datë 07.04.2010, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”

I. Neni 4 behet:

Formularët dhe te dhenat e kerkuara nga AKEP

1. *Informacioni dhe te dhenat qe duhet te dergojne sipermarresit e autorizuar per ofrimin e rrjeteve dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike percaktohen nga AKEP nepermjet formulareve dhe sipermarresi do te shkarkoje formularët nga moduli on-line ne cdo faze per te cilen eshte detyrim ligjor plotesimi i tyre.*
2. *Formularët perfshijne:*
 - a. *Te dhena dhe tregues vjetore te ofrimit te sherbimeve dhe rrjeteve publike te komunikimeve elektronike:*
 - i. **Formulari A:** *Ofrimi i rrjeteve dhe/ose sherbimeve te telefonise fikse;*
 - ii. **Formulari B:** *Ofrimi i sherbimeve te Internetit;*
 - iii. **Formulari C:** *Tregues vjetore te ofrimit te infrastruktures dhe kapaciteteve te rrjetit fikse;*
 - iv. **Formulari D:** *Ofrimi i rrjeteve dhe/ose sherbimeve te telefonise se levizshme;*
 - v. **Formulari E:** *Te dhena vjetore financiare.*
 - vi. **Formulari F:** *Te dhena vjetore per numrin e pajtimtareve sipas qarqeve, zonave urbane dhe rurale*
 - b. *Te dhena dhe tregues tre-mujore te ofrimit te sherbimeve dhe rrjeteve publike te komunikimeve elektronike*
 - i. **Formulari G:** *Te dhena tre mujore per sherbime dhe rrjete fikse*
 - ii. **Formulari H:** *Te dhena tre-mujore per sherbime dhe rrjete celulare*
3. *Formularët me treguesit perkates dhe shpjegimet e nevojshme jane pjese e kesaj rregulloreje (Aneks 1) dhe publikohen nga AKEP ne modulin perkates on-line (www.aplikimeonline.al). Drejtoria perkatese e AKEP pergjegjese per statistikat mund te kryeje saktësime te perkufizimeve dhe sqarimeve te treguesve te formularave per permiresimin e tyre.*
4. *AKEP mund te kerkoje te dhena shtese, jo te specifikuar ne formulare, nepemjet njoftimeve ne forme shkresore dhe/ose ne rruge elektronike, ne te cilat percaktohet lloji, afatet per dergimin e te dhenave si dhe qellimi i kerkeses.*

II. Neni 5 behet:

Afatet e plotesimit te formulareve dhe menyra e raportimit

1. *Informacioni dhe te dhenat e kerkuara sipas Formulareve G dhe H, raportohen on-line nga sipermarresi cdo 3 muaj:*
 - a. *Brenda dates **20 Prill** te cdo viti: te dhenat e Tremujorit te I-re Janar-Mars (Q1) te vitit kalendarik korrent;*

- b. Brenda dates **20 Korrik** te cdo viti: te dhenat e Tremujorit te II-te Prill-Qershor (Q2) te vitit kalendarik korrent;
 - c. Brenda dates **20 Tetor** te cdo viti: te dhenat e Tremujorit te III-te Korrik-Shtator (Q3) te vitit kalendarik korrent;
 - d. Brenda dates **20 Janar** te cdo viti: te dhenat e Tremujorit te IV-t Tetor-Dhjetor (Q3) te vitit kalendarik paraardhes;
2. Informacioni dhe te dhenat vjetore te kerkuara sipas Formulareve A, B, C, D, E dhe F raportohen on-line dhe depozitohen me shkrese nga sipermarresi cdo vit brenda dates **10 Prill** te vitit kalendarik pasardhes. Te dhenat dhe informacioni vjetor i raportuar perfshijne periudhen Janar-Dhjetor te vit paraardhes.
 3. Sipermarresi ka detyrimin qe per cdo periudhe raportimi:
 - a. te shkarkoje lokalisht nga moduli on-line i AKEP Formularet perkates ne varesi te sherbimeve qe ofron apo perfiton nga operatoret e tjere sipas shpjegimeve te dhena ne Formularet respektive.
 - b. te plotesoje formularet perkates sipas udhezimeve ne kete rregullore per afatet e raportimit dhe sipas pershkrimeve te dhena ne formularet e treguesve..
 - c. te ngarkoje formularet e plotesuar ne modulim on-line te AKEP.
 4. Per perdorimin e modulit on line te AKEP, sipermarresi mund te perdore ndihmesen qe ofrohet ne *MENUNE E MODULIT ON-LINE: "MANUALE TE NEVOJSHME "* ne zerin "*Raportime Formularesh*".

III. Shtohet nje Nen i ri me numrin 6 (nenet e mepashme kane nderruar numertim)

Neni 6

Cilësia e të dhënave

Sipërmarrësi duhet të garantojë plotësimin e të gjithë treguesve të kërkuar dhe të dhënat e raportuara duhet të jenë të krahasueshme me periudha të mëparshme raportimi. Sipërmarrësit duhet të sigurojnë integritetin e të dhënave përgjatë periudhave kohore të raportuara duke mbajtur një gjurmë të përshtatshme auditimi të mundshëm nga AKEP për të gjithë informacionin e raportuar, duke garantuar midis të tjerave:

1. *Plotesine informacionit*
Sipermarresi duhet te raportoje te gjitha te dhenat e kerkuara ne formulare te cilat jane te aplikueshme per aktivitetin e tij.
2. *Krahasueshmërine informacionit*
Sipërmarrësit duhet të raportojnë të dhënat duke iu referuar përskrimeve të dhëna nga AKEP dhe njëkohësisht treguesit e raportuar duhet të jenë të krahasueshëm në periudha të ndryshme. Në rast të ndryshimit të mënyrës së matjes së një treguesi nga sipërmarrësi, ai duhet të vendosë sqarimin përkatës, arsyen dhe vlerat e treguesit për periudhat e mëparshme të raportuara sipas mënyrë së re të matjes.
3. *Ruajtja e të dhënave*

Të gjitha informacionet e raportuara në AKEP duhet të ruhen nga sipërmarrësi, duke krijuar mundësinë për të provuar vërtetësinë e treguesve të raportuar dhe mënyrës së matjes së tyre, në rast verifikimi të tyre nga AKEP. Afati për ruajtjen të dhënave të raportuara dhe provat e matjes së tyre është 3 vjet.

IV. Neni 7 (-ish-neni 6) behet:

Verifikimi nga AKEP i te dhenave

Nese te dhenat e derguara nga sipermarresi nuk jane ne standartin e te dhenave te kerkuara nga AKEP dhe krijojne dyshime mbi saktesine e tyre:

- 1. AKEP mund te kerkoje sqarime sipermarresit apo Personit te kontaktit nepermjet te gjithave menyrove te komunikimit si: duke perdorur moduln on-line, me shkrese, me telefon dhe/ose me e-mail.*
- 2. Sipermarresi/Personi i kontaktit duhet te jape sqarime dhe informacionin e sakte qe ploteson kriteret e percaktuara ne formularet e te dhenave, brenda 10 diteve nga marrja e kerkeses se AKEP per sqarime te cituar ne piken ‘a’.*
- 3. AKEP mund te kryeje verifikime te saktetise se te dhenave te depozituara nga sipermarresi, nepermjet inspektimit ne ambientet/dokumentacionin e sipermarresit.*

V. Neni 8 (ish-neni 7) behet:

Perdorimi i te dhenave nga AKEP

- 1. AKEP, nepermjet Njesise pergjegjese per Statistikat, do te beje perpunimin e informacionit periodik te depozituar nga sipermarresi, infomacion i cili do te sherbeje si element baze per:*
 - a) Monitorimin e vazhdueshem te tendencave te tregut te komunikimeve elektronike ne Shqiperi per plotesimin e objektivave rregullatore te AKEP si dhe politiket sektoriale;*
 - b) Zhvillimin e analizave te tregut nga AKEP;*
 - c) Informacion per publikim per publikun e gjere nepermjet raporteve periodike qe evidentojne treguesit kryesore te zhvillimit te tregut:*
 - i. Te dhenat tre-mujore publikohen nga AKEP brenda 15 diteve nga afati i depozitimit te te dhenave nga sipermarresit;*
 - ii. Te dhenat vjetore publikohen nga AKEP brenda muajit Maj te vitit pasardhes.*
 - d) Plotesimin e kerkesave te institucioneve kombetare dhe nderkombetare qe monitorojne zhvillimin e tregut te komunikimeve elektronike ne Shqiperi;*
- 2. AKEP zbaton parimet e konfidencialitetit ne publikimin dhe perdorimin e te dhenave te tregut te komunikimeve elektronike.*

VI. Formularwt e treguesve te rrjeteve dhe sherbimeve tw komunikimve elektronike (Aneks 1 i Rregullores nr12, te miratuar me VKD nr. 1214 date 07.04.2010) zvwendwsohen me Formularwt e miratuar me kwtw vendim.

Aneks 2:



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

“Komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP mbi komentet”

në lidhje me dokumentin për Këshillim Publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. ne Rregulloren nr. 12, datë 07.04.2010, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”

Publikuar ne faqen e Internetit te AKEP www.akep.al, ne seksionin Konsultime te Perfunduara.